

## NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës – Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Fillim Skoro, kryetar, Xhevdet Abazi dhe Gani Zabeli, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Eroll Gashi, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit R.Z, nga ..., për shkak të veprës penale Vrasje nga neni 146 të KPK, duke vendosur për ankesat e Prokurorisë Themelore – DKR në Gjilan, përfaqësuesit të palës së dëmtuar av. Sh.P, nga ..., dhe mbrojtësit të të akuzuarit R.Z, av. I.M, të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore – DKR në ..., P.nr. 142/09 datë 07.11.2014, në seancën e kolegjit të mbajtur konform dispozitës së nenit 390 par. 1 të KPPK, më datë 24.03.2015, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

Me aprovimin e ankesës së Prokurorisë Themelore - DKR në Gjilan, si dhe përfaqësuesit të palës së dëmtuar, ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore – DKR në Gjilan, P.nr.142/09 datë. 07.11.2014, vetëm përkitazi me vendimin për dënim, ashtu që të akuzuarin R.Z, për veprën penale vrasje nga neni 146 të KPK, për të cilën është shpallur fajtor, e gjykon me dënim burgu në kohëzgjatje prej 12 (dymbëdhjetë) vjet, dënim ky në të cilin të akuzuarit i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 06.11.2007 e gjer me datën 11.09.2008 si dhe nga data 12.02.2014 e tutje.

Ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit refuzohet si e pabazuara, ndërsa aktgjykimi i ankimuar për pjesën tjetër vërtetohet.

## A r s y e t i m

Gjykata Themelore – DKR në Gjilan, me aktgjykimin P.nr.142/09 datë 07.11.2014, e ka shpallur fajtor të akuzuarin R.Z, për veprën penale Vrasje nga neni 146 të KPK, dhe për këtë vepër penale e ka gjykuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 8 (tetë) vjet, në të cilin dënim të akuzuarit i ka llogaritur edhe kohën e kaluar në paraburgim nga data 06.11.2007 e deri më

datën 11.09.2008 si dhe prej datës 12.02.2014 e gjer në plotfuqishmërinë e aktgjykimi. Të akuzuarin e ka detyruar që t'i paguajnë shpenzimet e procedurës penale sipas llogaris përfundimtare të gjykatës, ndërsa në emër të shumës së paushallit gjyqësor shumë prej 50 (pesëdhjetë) €, të gjitha në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesa kanë paraqitur:

- Prokuroria Themelore – DKR në ..., për shkak të vendimit për dënimin, me propozim që të ndryshohet aktgjykimi i shkallës së parë përkitazi me vendimin për dënim, dhe të akuzuarit t'i shqiptoj dënim më të ashpër me burgim.

- Përfaqësuesi i palës së dëmtuar av. Sh.P, nga ..., për shkak të vendimit mbi dënim, me propozim që të ndryshohet aktgjykimi i shkallës së parë, përkitazi me vendimi për dënim, ashtu që të akuzuarit ti shqiptoj dënim më të rëndë me burgim.

-Mbrotësi i të akuzuarit R.Z , av. I.M, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit për dënimin, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe i akuzuari të lirohet nga akuza për veprën penale që i vihet në barrë, ose ta anuloj dhe çështjen ta kthejë në rivendosje.

Gjykata e Apelit, seancën e kolegjit e mbajti konform dispozitës së nenit 390 par. 1 të KPPK, për të cilën njoftoi Prokurorin e Apelit, të dëmtuarit , të akuzuarin dhe mbrotësit e ti. Në seancën e kolegjit ishin të pranishëm i dëmtuari G.H, përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuar av. Sh.P, i akuzuari R.Z dhe mbrotësi i ti av.I.M, të cilët pasi sqaruan ca nga pretendimet që dalin nga ankesat, ngelën pranë propozimeve të bëra në to. I akuzuari përkrahu pretendimet ankimore të mbrotësit të ti. Në seancë nuk prezantoi Prokurori i Apelit edhe pse ishte i njoftuar në mënyrë të rregullt, për çka gjykata bazuar në dispozitat e nenit 391 par. 4 të KPPK, seancën e mbajti në mungesë të prokurorisë.

Prokuroria e Apelit e Kosovës, me parashtresën PPA.nr.83/15 datë 17.02.2015, ka propozuar që ankesa e Prokurorisë Themelore – DKR në ... si dhe ajo e përfaqësuesit e palës së dëmtuar të aprovohen, ashtu që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënim më i rënd me burg, kurse ajo e mbrotësit të të akuzuarit të refuzohet si e pabazuara.

Gjykata e Apelit, pasi shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështjeje penalo-juridike, studioi aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPPK dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesa, gjeti se:

Ankesa e Prokurorisë Themelore – DKR në ... dhe ajo e përfaqësuesit të palës së dëmtuar janë të bazuara, ndërsa ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit nuk është e bazuar.

Në ankesën e paraqitur të mbrojtësit të të akuzuarit, pretendohet se aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të parapara sipas dispozitës së nenit 384 par.1 nënpar.12 dhe par 2 të KPPK, sepse dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm, kundërthënës në brendinë e tij, në arsyetim nuk janë paraqitur arsyerat lidhur me faktet vendimtare, kurse arsyerat që janë paraqitur janë plotësisht të paqarta dhe në masë të konsiderueshme kundërthënëse, pastaj ka kundërthënie të konsiderueshme ndërmjet asaj që paraqitet në arsyetimin e aktgjykimit lidhur me përmbajtjen e shkresave, pastaj aktgjykimit në fjalë i mungon vlerësimi i provave dhe fakteve kundërthënës dhe atë sidomos vlerësimi i deklaratave të dëshmitareve B.H e A.H, pastaj nuk janë dhënë arsyerat për mos aprovimin e propozimeve të palëve si dhe nuk ka arsye në bazë të të cilave është bazuar gjykata në vendosjen e kësaj çështje penalo juridike sidomos përkitazi me vërtetimin e ekzistimit të veprës penale. Kështu, gjithëherë sipas pretendimeve ankimore, i akuzuari në të gjitha fazat e procedurës në këtë çështje penalo - juridike, e ka mohuar kryerjen e veprës penale me arsyetim se ka vepruar në mbrojtje të nevojshëm nga se pasi shkon në vendin e ngjarjes për të larguar bagëtinë e të ndjerit nga prona e ti, e ka dëgjuar dëshmitarin B.H, kur i ka thënë të ndjerit “Mos me Brisk” dhe derisa është kthyer ballë për ballë me të ndjerin ka vrenjtur se është therur në anën e majtë të belit dhe kur i ndjeri prapë fillon ta sulmoj, i akuzuari me qëllim të zbrapsjes së sulmit ka nxjerrë thikën nga beli dhe e ka goditur tani të ndjerin. Shkelje tjetër esenciale të dispozitave të procedurës penale në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar është bërë kur gjykata e shkalles së parë, nuk ka aprovuar propozimin e mbrojtësit të të akuzuarit për dëgjimin edhe të pesë dëshmitareve – anëtarë të Këshillit të Pajtitimit, pastaj po ashtu gjykata nuk ka zbatuar dispozitat e nenin 311 të KPPK-së, ku seancën e shqyrtimit gjyqësor të ndërpre e ka caktuar pas 4 muajsh e duke mos filluar seancën tjetër konform dispozitave të KPK-së, shkelje këtë të gjitha esenciale të dispozitave të procedurës penale që kanë rezultuar pastaj edhe me vërtetimin e gabuar dhe jo të plot të gjendjes faktike dhe shkelje të ligjit penal në dëme të të akuzuarit, kur i akuzuari është shpallur fajtor për vepre penale të vrasjes nga nenin 146 të KPK-së.

Gjykata e Apelit, gjen se pretendimet ankimore të cekura si më lartë nuk qëndrojnë, nga se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të pretenduara në ankesë e as shkelje tjera të cilat kjo gjykatë i shqyrton edhe sipas detyrës zyrtare, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e aktgjykimit. Dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është i qartë, konkret, nuk përmban kundërthënie me vetveten, e as me arsyetimin e tij. Në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar janë dhënë arsye të mjaftueshme faktike dhe juridike, të cilat i aprovon edhe kjo gjykatë, duke vënë në dukje se cilat fakte dhe për çfarë arsyerash i merr si të provuara ose të pa provuara, duke bërë vlerësimin e provave kontradiktore konform dispozitave të nenit 370 par.7 të KPPK. Gjykata e shkallës së parë ka bërë vlerësimin dhe analizën e të gjitha provave të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, duke i paraqitur lidhur me këto përfundime e veta, të cilat si të drejta e të ligjshme i aprovon edhe kjo gjykatë. Kështu në rastin konkret gjykata e shkallës së parë përkitazi me fakte vendimtare, përveç mbrojtjes së të akuzuarit, i cili nuk i konteston faktet se ditën kritike ka shkuar në vendin e ngjarjes dhe pas një konflikti të drejtpërdrejtë fizik me të ndjerin, të njëjtin e ka thirrë me thikë në kokë, i cili pastaj, pra i akuzuari është larguar nga vendi i ngjarjes, ndërsa tani i ndjeri nga dëshmitarët është dërguar në Qendrën Emergjente ku të nesërmen edhe ka vdektë, ka marr parasysh edhe deklarata e dy dëshmitareve okular B.H dhe A.H, e po ashtu edhe deklaratën e dëshmitarët tjetër H.H, nga e cila, pra ky i fundit, ka vërtetuar se në vendin e ngjarjes ka qenë edhe i mituri – dëshmitari A.H, pastaj, pra në bazë të këtyre dy deklaratave të dy dëshmitareve okular në vendin e ngjarjes, edhe nuk është aprovuara mbrojtja e të akuzuarit se në vendin e ngjarjes nuk ka qenë edhe i mituri – dëshmitari A.H. Ndërsa përkitazi me pretendimet ankimore të të akuzuarit se ditën kritike ka vepruara në mbrojtje të nevojshme, gjykata e shkallës së parë nuk ka aprovuar një mbrojtje të tillë duke u bazuar pikërisht në deklaratat e dëshmitareve okular në vendin e ngjarjes, pra të dëshmitareve B.H dhe A.H, për çka sidomos është e rëndësishme të cekët këtu deklarata e dëshmitarit të mitur A.H, e cila deklarata përveç që përputhet me deklaratën e dëshmitarit tjetër B.H, e njëjta ka mbështetje edhe në vet mbrojtjen e të akuzuarit, i cili – pra i akuzuari nuk i mohon faktet dhe rrethanat përkitazi me konfliktin dhe kacafytjen që ka ndodhur në mes të akuzuarit dhe tani të ndjerit Sh.H, ku edhe ka ardhur deri edhe te goditja e të ndjerit me thikë, e duke shkaktuar kështu lëndime të rënda trupore si pasoj e të cilave vdesë ne QKUK në Prishtinë. Gjithashtu është me rëndësi të cekëte se gjykata e shkallës së parë ka paturë parasysh, përkitazi me mbrojtjen e të akuzuarit se ka qen i sulmuar nga tani i ndjeri Sh.H, edhe ekspertizën e ADN-së, për të cilinë ka dhënë vlerësimin e saj edhe përkitazi me plagën që i është shkaktuar të akuzuarit nga i ndjeri Sh.H, pastaj po ashtu ka marr parasysh edhe faktin se para fillimit të konfliktit tani i ndjeri ka poseduar një brisk në dorë, faktet dhe rrethana këto që i vërteton

edhe dëshmitari B.H, mirëpo edhe për kundër fakteve në fjalë, me të drejt nuk ka aprovuar pretendimin e të akuzuarit se ka vepruar në mbrojtje të nevojshëm, çka me në detaje përkitazi me faktet në fjalë do të flitet gjatë elaborimit të pretendimeve ankimore për gjendjen faktike në këtë qeshje penalo – juridike, ku edhe rezulton se i akuzuari nuk ka vepruar në mbrojtje të nevojshme, sikur që pretendohet me ankesë. Po ashtu nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë nuk ka dhen arsye për mos aprovimin e propozimit të mbrojtjes për dëgjimin e dëshmitareve, nga se dëshmitaret e propozuar nga mbrojtja (është fjala për propozimin për dëgjimin e pesë dëshmitareve – anëtar të Këshillit të Pajtitimit), për të cilët gjykata e shkallës së parë ka refuzuar propozimin, me arsyetim se të njëjtit nuk janë dëshmitar okular dhe se faktet dhe rrethanat, për të cilat edhe është propozuar që të dëgjohen dëshmitaret e cekur me lart, janë irelevante për vërtetimin e gjendjes faktike, për çka një vlerësim të tillë e aprovon edhe Gjykata e Apelit, nga se nga vetë propozimi rezulton se mbrojtësi ka kërkuar që të dëgjohen dëshmitarët në fjalë për vërtetimin e faktit se i akuzuari është pajtuar me familjen e të dëmtuarit por edhe që ka qenë i obliguar që të largohet nga fshati, rrethana këto pra që nuk kanë të bëjnë me gjendjen faktike që ka ndodhur ditën kritike, ndërsa faktet tjera gjykata i ka vërtetuar me provat materiale si procesverbalin e pajtitimit në shkresat e lëndës, prandaj nuk ka shkelje të dispozitave procedurale në këtë drejtim, sikur që natyrisht nuk qëndrojnë as pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë nuk ka zbatuar dispozitat e nenin 311 të KPPK-së, përkitazi me ndërprerjen dhe vazhdimin e seancave të shqyrtimit gjyqësor, nga se nga procesverbalin i shqyrtimit gjyqësor të datës 16. 06.2014 vërtetohet se gjykata e shkallës së parë ka rihapur seancën e shqyrtimit gjyqësor për shkak të kalimit të afatit prej tre muajsh nga seancë e fundit, dhe pastaj ka vazhduar me seancën tjetër të radhës me datën 10.09.2014, pra pa kaluar afati prej tre muaj nga seanca e fundit, dhe ka vazhduar me seancën tjetër me datën 20.10.2014 dhe po ashtu prapa me seancën tjetër të radhës me datën 07.11.2014, e kështu me radhë, pra pa shkelur dispozita procedurale të KPPK, të parapara për shtyrjen dhe vazhdimin e seancës së shqyrtimit gjyqësor konform dispozitave të nenit 311 të KPPK.

Përkitazi me bazën ankimore vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike, me ankesë, në esencë kontestohet vetëm mënyra e vlerësimit të provave të proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor nga ana e gjykatës së shkallës së parë si dhe konkludimet të cilat ajo i ka nxjerrë të bazë të provave të proceduara. Pretendohet se provat janë vlerësuar në mënyrë të gabuar dhe të njëanshme, prandaj edhe përfundimet kanë pasuar të gabuara, pa mbështetje në prova. Kështu, sipas pretendimeve të mbrojtësit gjykata e shkallës së parë gabimisht dhe në mënyrë jo të plotë ka vërtetuar gjendjen

faktike, ngase nuk ka marr parasysh ekspertizën e ADN-së, ku konstatohet se edhe i akuzuari ka qenë i goditur nga tani i ndjeri me thikën e ti e që është gjetur në vendin e ngjarjes, provë kjo pra që demanton deklaratat e dy dëshmitareve, se vetëm i akuzuari e ka goditur të ndjerin, fakte këto pra vendimtare nga të cilat do të konstatohet se i akuzuari ka vepruar në mbrojtje të nevojshme, e jo i njëjti të shpallet fajtor për vepër penale të vrasjes.

Gjykata e Apelit, konstaton, se edhe përkitazi me këtë bazë ankimore nuk qëndrojnë pretendimet e cekura si me lartë, nga se me pa mëdyshje, pra edhe nga vete mbrojtja e të akuzuarit, gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar fakte dhe rrethanat se ditën kritike, i akuzuari pasi vëren bagëtinë e tani të ndjerit dhe të dëshmitarit B.H se ishin futur në pronën e tij, i njëjti nisat për në drejtim të tyre me një biçikletë dhe pasi ofrohet aty pari, pastaj vazhdon në këmbë në drejtim të tani të ndjerit dhe dëshmitareve në vendin e ngjarjes, ku pasi i ofrohet të ndjerit dhe dëshmitarit B.H, të njëjtit i pyet se pse i kanë futur kafshët në pronën e ti, ku fillon përleshja dhe pastaj edhe konflikti fizik në mes tani të ndjerit Sh.H dhe të akuzuarit, ku nga goditja që merr i ndjeri Shaban me thikën e të akuzuarit në kokë pas veshit të djathtë, humb vetëdijen në vendin e ngjarjes dhe pas dërgimit për ndihmë mjekësore në ..., pastaj edhe në QKUK në Prishtinë, të nesërmen si pasojë e plagëve në fjalë edhe vdes. Po ashtu jo kontestuese janë edhe faktet se në konfliktin në fjalë, goditje me thikë ka marr edhe i akuzuari edhe atë në pjesën e belit e që me ekspertizën e mjekësisë ligjore të ADN-së është vërtetuar se plaga në fjalë është shkaktuar me thikën e tani të ndjerit, thikë kjo e cila është gjetur në vendin e ngjarjes e të cilën i ndjeri e ka patur në dorë e duke e gdhendur një shtagë druri dhe atë në momentin kur ka filluar konflikti fizik në mes tani të ndjerit dhe të akuzuarit. Faktet dhe rrethanat në fjalë po ashtu kanë mbështetje edhe në deklaratat e dëshmitarëve B.H, A.H, pastaj në provat materiale si ekspertizën e mjekësisë ligjore, raporti i autopsisë, deklarata e ekspertit mjeko ligjor, ekspertiza e ADN-së si dhe foto dokumentacionin dhe shkresat tjera në lëndë.

Ndërsa përkitazi me faktet kontestuese, se a ka vepruar i akuzuari në mbrojtje të nevojshme pra që duke dashur ta zmbraps sulmin e tani të ndjerit të këtë goditur me thikë tani të ndjerin, pra pasi më parë e ka qëlluar me brisk tani i ndjeri të akuzuarin, apo i akuzuari e ka qëlluar me thikë të ndjerin pas një grindje të shkurt dhe konflikti fizik, gjykata e shkallës së parë përkitazi me faktet kontestuese, ka dëgjuar dëshmitarin B.H, dëshmitar ky okular në vendin e ngjarjes, nga deklarata e të cilit ka vërtetuar se ditën kritike dëshmitari ka qenë së bashku me tani të ndjerin Sh.H dhe dëshmitarin tjetër-të miturin A.H, duke ruajtur bagëtinë dhe delet dhe për një moment ka vërejtur të akuzuarin R.B, duke ardhur me biçiklete dhe pasi biçikletën e ka

lënë në rrugë, me vrap është nisur në drejtim të tyre njëkohësisht duke sharë dhe ofenduar , ndërsa kur i afrohet tani të ndjerit, i cili në atë moment ishte duke e gdhend një shtagë të drurit me briskun e ti, i akuzuari i është drejtuar me fjalët “pse i ke shti bagëtinë në arën time, nënën e pisit” ndërsa i ndjeri nuk ka reaguar fare mirëpo i akuzuari pasi i afrohet të ndjerin e kap për gjoksi dhe pastaj ka ndërhy dëshmitari B.H, duke tentuar që ta pengoj të akuzuarin por tani i akuzuari e ka shtyrë dëshmitarin me dorë dhe e ka larguar për afërsisht një metër nga i ndjeri, e pastaj i akuzuari prapë e ka kapur të ndjerin për gjoksi dhe nga brezi ka nxjerr pastaj një brisk i cili kishte qenë i hapur dhe e ka goditur me dorën e ti të majtë në kokë dhe atë në pjesën e djathtë mbi vesh, ku edhe nga plagët tek i ndjeri ka filluar gjakderdhja dhe pasi i ndjeri vazhdon të largohet duke ecur tre-katër hapa është rrezuar në tokë dhe ka humbur vetëdijen, ndërsa i akuzuari ka ikur nga vendi i ngjarjes. Faktet dhe rrethanat në fjalë, gjykata e shkallës së parë, i ka vërtetuar edhe nga dëshmitari tjetër A.H, i cili po ashtu vërteton se ditën kritike ishte së bashku me tani të ndjerin Sh.H dhe dëshmitarin B.H, duke ruajtur bagëtinë dhe delet, kur pa prituri ka ardhur i akuzuari R.Z, i cili më parë kishte lënë biçikletën në rrugë, e pastaj duke vrapuar dhe bërtitur i drejtohet tani të ndjerit Sh.H, të cilit përveç që i drejtohet më fjalët “hajt qen a i ke shti delet për me livrua arën” të njëjtit ja shan edhe nënën, e pastaj edhe fillon të kacafytet me të ndjerin, ku pastaj dëshmitari B.H, tenton ta largoj të akuzuarin, por i njëjti e shtyn dëshmitarin B.H duke e rrezuar për toke, e pastaj i akuzuari me thikë e godet tani të ndjerin në kokë dhe largohet nga vendi i ngjarjes.

Faktet dhe rrethanat në fjalë, përveç dëshmitarëve okular gjejnë mbështetje edhe në deklaratat e dëshmitarëve H.H, J.H dhe A.B, prandaj sipas vlerësimit të kësaj gjykate, i drejtë dhe plotësisht i arsyeshëm dhe i bazuar në ligj është konkludimi i gjykatës së shkallës së parë kur konstaton gjendjen faktike të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, nga se i akuzuari ka ardhur në vendin e ngjarjes duke ofenduar dhe fyer të ndjerin e pastaj edhe duke e kërcënuar dhe menjëherë edhe ka filluar konfliktin fizik, duke e kapur për gjoksi të ndjerin dhe pasi pengohet nga dëshmitari B.H, i akuzuari prapë, pasi më parë e largon dëshmitarin B.H e duke e hedhur për toke larg një metër, prapa e kap për gjoksi të ndjerin dhe pas një përleshje – konflikti fizik edhe e godet me thikën e ti në kokë, ndërsa, gjithëherë sipas deklaratave të dy dëshmitarëve, i ndjeri nuk ka ndërmarrë kurrfarë sulmi të kundërligjshëm, real e të atëçastshëm ndaj të akuzuarit, por përkundrazi i ndjeri ka qenë i sulmuar –kuptohet pasi më parë është fyer dhe kërcënuar nga i akuzuari, prandaj pavarësisht faktit se i akuzuari është lënduar me briskun e të ndjerit në bel, gjë që ka mundur të ndodh në konflikt e sipër, kurrësi kjo nuk do të thotë se i akuzuari ka vepruar në mbrojtje të nevojshme, nga se ai- pra i akuzuari nuk ishte i sulmuar as i kërcënuar e as i

ofenduar nga tani i ndjeri Sh.H, ndërsa briskun e posedonte tani i ndjeri që në momentin e arritjes së të akuzuarit duke e gdhendur një shtagë të drurit dhe për një moment i ndjeri është sulmuar nga i akuzuari, kështu që në kacafytje e sipër ka ardhur deri te lëndimi edhe i të akuzuarit në bel me briskun e të ndjerit, pra natyrisht pasi që ishte i sulmuar nga i akuzuari edhe tani i ndjeri me siguri që ka reaguar me briskun e ti, mirëpo kjo ka ndodhur pasi është sulmuar më parë nga i akuzuari, ngase dy dëshmitaret vërtetohet se i akuzuari më parë ka fyer dhe ofenduar e pastaj edhe e ka sulmuar të ndjerin, ndërsa vetë i akuzuari nuk i mohon faktetë se ka ardhur në drejtim të tyre e duke kërkuar nga të njëjtit llogari për bagëtinë dhe delet që i kishin futur në pronën e ti.

Duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat e sipër përmendura si dhe rrethanat dhe arsyerat më detajishte të theksuara në aktgjykimin e ankimuar, rezulton se konkludimi i gjykatës së shkallës së parë se i akuzuari R.Z, ka kryer veprën penale Vrasje nga neni 146 të KPK, është i drejte dhe se në mënyrë të padyshimtë është vërtetuar se i akuzuari ka ndërmarrë veprimet inkriminuese të cilat përbëjnë tiparet e veprës penale për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor, prandaj, nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se është shkelur ligji penal në dëm të akuzuarit, nga se me asnjë provë nuk vërtetohet se i akuzuari ka vepruar në mbrojtje të nevojshëm, sikur që pretendohet me ankesë .

Duke e shqyrtuar çështjen përkitazi me vendimin për dënimin, Gjykata e Apelit, gjen se pretendimet ankimore të prokurorisë dhe përfaqësuesve të palës së dëmtuar se dënimi i shqiptuar është i but dhe jo adekuat, me rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale, janë të bazuara, ndërsa ato të mbrojtësit të të akuzuarit nuk janë të bazuar. Me ankesën e Prokurorisë, pretendohet se dënimi i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë është i butë dhe në disproporcion të thellë me shkallen e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe atë të përgjegjësisë penale të akuzuarit, nga se përveç rrethanave lehtësues dhe rënduese të konstatuara, nuk ka marr parasysh edhe rrethanat tjera rënduese dhe atë sidomos mënyrën e kryerjes së veprës penale, rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale, e sidomos faktin se vepra penale në fjalë është kryer në prezencën edhe të personave të tjerë e tekë të cilët është shkaktuar shqetësim i madh, pastaj sjelljen e të akuzuarit pas kryerjes së veprës penale, ku i akuzuari ka qenë në arrati deri në rastin e arrestimit në bazë të urdhër arrestit. Ndërsa në ankesën e përfaqësuesit të palës së dëmtuar pretendohet se edhe pse gjykata e shkallës së parë ka konstatuar rrethana lehtësues dhe rëndues me rastin e shqiptimit të dënimit, të nëjeita nuk i ka vlerësuar realisht nga se dënimi i shqiptuar nuk është në harmoni me shkallen e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale. Kurse



mbrojtësi i të akuzuarit në ankesën e ti, përkitazi me këtë bazë ankimore nuk ka thënë asgjë shprehimisht duke konsideruar se në rastin konkret i akuzuari duhet të lirohet nga akuza ose aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja të kthehet në rivendosje, ndërsa përkitazi me vendimin për dënim nuk ka theksuar as një fjalë të vetme.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e shqiptimit të dënimit duke vlerësuar rrethanat konform dispozitave të nenit 73 të KPK, si rrethana lehtësues për të akuzuarin R.Z ka marrur se është i martuar, baba i katër fëmije nuk ka qenë i dënuar, dhe sjellja korrekte në gjykatë, ndërsa nga rrethanat rënduese ka marrë peshën e veprës penale, mënyrën e kryerjes së veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale të e sidomos faktin se i akuzuari ka qenë në arrati.

Mirëpo, sipas vlerësimit të kësaj gjykate, gjykata e shkallës së parë në këtë çështje penale – juridike drejt i ka konstatuar rrethanat letësuse dhe rënduese të cilat i ka gjetur tek i akuzuari, por të njëjtat nuk i ka vlerësuar realisht dhe atë sidomos faktin se i akuzuari e ka iniciuar konfliktin fizik ditën kritike, pastaj pasoja e shkaktuar- është fjalë pra për persona të moshës së mesme, pastaj sjelljen e të akuzuarit pas kryerjes së veprës penale, ku i njëjti ka qëndruar një kohë të gjatë në arrati dhe i njëjti është lajmërua vetëm pasi që është lëshuar urdhër-arresti nga gjykata, prandaj me vlerësimin real të rrethanave të konstatuara nga gjykata e shkallës së parë po edhe të këtyre nga kjo gjykatë, rezulton se dënimi i shqiptuar nga Gjykata e Apelit, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, është në harmoni me shkallen e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, përgjegjësisë penale të të akuzuarit, me rrethanat e rastit konkret dhe se me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitat e nenit 41 të KPK-së.

Nga sa u tha më lartë e konform dispozitës së nenit 401 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
PAKR.nr.82/2015, më 24.03.2015

Procesmbajtës,  
Eroll Gashi

Anëtarët e kolegjit,

Kryetar i kolegjit,  
Fillim Skoro

1. Xhevdet Abazi

2. Gani Zabeli